

Datë: 19.09.2024

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Mallra

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Blerje e laboratoreve të lëndëve të përgjithshme, blerje makineri dhe pajisje për repartet e praktikave profesionale, kafshë etj per shkollat bujqesore”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT(FPP):

39162100-6 (pajisje për mësimdhënie)

VLERA E FONDIT LIMIT: 155.544.440 (njëqind e pesëdhjetë e pesë milion e pesëqind e dyzet e katër mijë e katërqind e dyzet) lekë pa tvsh ose 1,567,198 (një milion e pesëqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e njëqind e nëntëdhjetë e tetë) Euro pa TVSH, e ndarë në lote si më poshtë:

Loti 1 “Blerje pajisje për kabinetet e Hoteleri-Turizëm” me fond limit 37.197.364 (tridhjetë e shtatë milion e njëqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e treqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë pa tvsh ose 374,784 (treqind e shtatëdhjetë e katër mijë e shtatëqind e tetëdhjetë e katër

Loti 2 “Blerje pajisje për kabinetet e shërbimit të mjeteve të transportit” me fond limit 36.737.283 (tridhjetë e gjashtë milion e shtatëqind e tridhjetë e shtatë mijë e dyqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa tvsh ose 370,149 (treqind e shtatëdhjetë mijë e njëqind e dyzet e nëntë) Euro pa TVSH.

Loti 3 “Blerje pajisje për Kabinetet Mekanike/Elektronike” me fond limit 49.736.860 (dyzet e nëntë milion e shtatëqind e tridhjetë e gjashtë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë) lekë pa tvsh ose 501,127 (pesëqind e një mijë e njëqind e njëzet e shtatë) Euro pa TVSH.

Loti 4 “Blerje pajisje për Kabinetet Bujqësore” me fond limit 31.872.933 (tridhjetë e një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e tridhjetë e tre) lekë pa tvsh ose 321,138 (treqind e njëzet e një mijë e njëqind e tridhjetë e tetë) Euro pa TVSH.

Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë më datë 19.09.2024 është 99.25.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor, Operatori i Blerjeve të Përqëndruara, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar:

Argumentimi i kritereve të përbashkëta për të katër lotet:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetedeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 26 të VKM-se nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" të ndryshuar.

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas kërkesave të përcaktuara në Kriteret e Përgjithshme të Pranimit/ Kualifikimit shtojca 8.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 76 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 25 të VKM-se nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin deklaratat për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023, dhe vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më të vogël se 40% e vlerës së fondit limit të përllogaritur.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar; nenin 43 pika 2/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në pikën 2 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023“Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar ku përcaktohet se: “ Deklarata tatimore vjetore dorëzohet në organin tatimor jo më vonë se data 31 mars e vitit pasardhës të vitit tatimor për të cilin dorëzohet deklarata”. Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim krijim e bindjes tek Autoriteti Kontraktor, për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomike dhe financiare për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vlera e kërkuar jo më e vogël se 40% e vlerës së fondit limit të këtij është brenda kufirit të përcaktuar në nenin 43 pika 2/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar, ku përcaktohet se “Vlera e xhiros minimale vjetore që u kërkohet operatorëve ekonomikë nuk mund të tejkalojë: a) dyfishin e vlerës së përllogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar”.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2021, 2022, 2023, të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, vetëm në rastin kur

janë në kushtet e përcaktimeve të nenit 41, të Ligjit Nr.10091 datë 05.03.2009 "Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar" të ndryshuar, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar; nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", u përcaktohet se: "*Nëse vlerësohet, autoriteti/enti kontraktor mund të kërkojë që operatorët ekonomikë të japin informacione në bilancet e tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojnë raportet, ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Nëse kërkohen një ose dy bilance, kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse në bilancin/et e kërkuara nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit*", si dhe në pikën 5 të nenit 61, të Ligjit nr.29/2023 "Për tatimin mbi të ardhurat", të ndryshuar ku përcaktohet se: "*.....Tatimpaguesit që mbajnë kontabilitet sipas kërkesave të ligjit përkatës, paraqesin deklaratën vjetore së bashku me pasqyrat financiare, si dhe të dhëna të tjera të përcaktuara në udhëzimin e ministrit përgjegjës për financat për zbatimin e këtij ligji.*", si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri, për paraqitjen e bilanceve, është vendosur duke pasur në konsideratë objektin e kontratës, natyrën dhe volumin e saj, që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorit ekonomik, të cilët duhet të vërtetojnë se zotërojnë kapacitetet e nevojshme ekonomike dhe financiare, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

2.3 Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 40% të vlerës së përlllogaritur të fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" të ndryshuar dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar. Përqindja e kërkuar është konsideruar e nevojshme për të provuar

besueshmërinë dhe provojën e operatorëve ekonomik ofertues, në ofrimin e mallrave të ngjashëm me objektin e prokurimi, për realizimin e kontratës me sukses.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të ketë Autorizim/Marrëveshje me prodhuesin/distributorin e autorizuar nga prodhuesi për mallrat objekt prokurimi. Në rast të paraqitjes së autorizimit nga distributori i autorizuar nga prodhuesi duhet të provohet lidhja ndërmjet prodhuesit dhe distributorit zyrtar të autorizuar nga prodhuesi. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: (*telefon, fax, e-mail, ëbsite*) të nevojshme për autoritetin kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri AK gjykon se autorizimi i prodhuesit ose distributorit të autorizuar është një dokument i rëndësishëm i cili garanton se ofertuesi është i autorizuar për ofrimin tek AK të këtyre mallrave. Kjo garanci lidhet njëkohësisht edhe me treguesit cilësorë të mallrave që kërkohen të blihen e që janë prodhuar në përputhje me standardet. Ky kriter është në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës dhe lidhet drejtpërdrejtë me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë e OE ofertues. Kjo kërkesë i shërben autoritetit kontraktor për njohjen e mundësisë së OE-se për përmbushjen me sukses të kontratës.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë katalog / skedën teknike për të gjitha mallrat objekt prokurimi për të cilat oferton ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat e mallit/mallrave që do të ofrohen, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmëria e tyre me specifikimet teknike dhe standartet e kërkuara në dokumentat standarte të tenderit. Gjuha e dokumentit duhet të jetë anglisht ose shqip.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 të ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe në nenin 40 të VKM Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar si dhe për të verifikuar plotësimin e specifikimeve teknike të mallrave, objekt prokurimi.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë ofertën teknike për artikujt objekt prokurimi në formatin si më poshtë:

Nr	Artikulli	Emri i kompanisë prodhuese	Origjina e mallit	Emertimi i katalogut të produktit	Numri i faqes ku ndodhet produkti	Numri referencës së produktit(kodi) i nxjerre nga katalogu i prodhuesit	Certifikimet perkatëse për produktet
1							

2							
etj							

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr.162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Kjo kërkesë është vendosur në bazë të natyrës specifike të kësaj procedure prokurimi duke pasur parasysh numrin e madh të zërave dhe duke synuar një organizim të informacionit në mënyrë për ti ardhur në ndihmë AK për një vlerësim sa më efektiv dhe në kohë të shkurtër.

2.3.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit, shpërndarjen dhe montimin e të gjithë mallrave në adresat e përcaktuara.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 4 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” të ndryshuar dhe nenit 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të deklarojnë se marrin përsipër shërbimet e kërkuara në adresën e përcaktuara nga autoriteti kontraktor.

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë garancie për mallrat objekt prokurimi për një periudhë minimale prej 1 (nje) viti nga data e dorëzimit të tyre.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Vendosija e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t'u garantuar se mallrat objekt prokurimi do të përmbushin kërkesat teknike dhe do të mbulohen të gjitha problematikat (defektet) që mund të lindin, jo për shkak të Autoritetit. Çdo prodhues ose distributor shitës ofron garanci për mallrat për një afat të caktuar. AK-ja ka kërkuar garanci me afatet e mësipërme sipas tipologjisë së mallrave e cila mbulon defekte (probleme) që vijnë nga prodhimi pas blerjes.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë Çertifikatën ISO 9001:2015 “Mbi sistemet e menaxhimit të cilësisë” (e vlefshme) ose ekuivalent, të lëshuara nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga organizmi kombëtar akreditues, ose organizma ndërkombëtare akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, në përputhje me objektin e prokurimit.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenet 77 dhe 79 të LPP, të pikës 1, nenit 44, të VKM-së nr.285 datë 09.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Ky kriter është kërkuar me qëllim që operatorët ekonomikë që do të zbatojnë kontratën të jenë çertifikuar në sistemin e menaxhimit të cilësisë sipas objektit të kësaj kontrate. Ky standard përcakton kërkesat për një sistem menaxhimi të cilësisë dhe mund të implementohet dhe të çertifikohet çdo shoqëri, pavarësisht dimensioneve apo fushës së aktivitetit. Kjo certifikate lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës për sa kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i

shërben autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës me cilësi dhe në kohë.

Argumentimi i kriterëve të veçanta për të lotin 4:

Loti 4 “Blerje pajisje për Kabinetet Bujqësore”

2.3.6 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë garancie për:

- Zërin “Traktor për punim të thellë të tokës” për një periudhë jo më pak se 3 vite ose minimumi 1000 orë pune, në varësi se cili kusht do të plotësohet i pari.
- Zërat “Rimorkio” dhe të gjitha *mjetet e pamotorizuara* për një periudhë jo më pak se 3 vite.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të Ligjit nr.162, datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" të ndryshuar dhe nenin 40 pika 8 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", të ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t'u garantuar se mallrat objekt prokurimi do të përmbushin kërkesat teknike dhe do të mbulohen të gjitha problematikat (defektet) që mund të lindin, jo për shkak të Autoritetit. Çdo prodhues ose distributor shitës ofron garanci për mallrat për një afat të caktuar. AK-ja ka kërkuar garanci me afatet e mësipërme sipas tipologjisë së mjeteve e cila mbulon defekte (probleme) që vijnë nga prodhimi pas blerjes.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë ku merr përsipër targimin për mjetin “Traktor për punim të thellë të tokës”, shoqëruar me dokumentacionin tekniko - ligjor sipas legjislacionit shqiptar në fuqi.

Argumentim: Në bazë të nenit të 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit, referuar edhe legjislacionit në fuqi i shërben autoritetit kontraktor për t'u garantuar se mjeti “Traktor për punim të thellë të tokës” do të dorëzohet pranë AK i pajisur me të gjithë dokumentacionin e rregullt tekniko-ligjor, i gatshëm për qarkullim rrugor.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike:

Specifikimet teknike (për të 4 lotet) janë hartuar nga një grupe të posaçme pune, përcjellë pranë OBP, nga MEKI, në përputhje me ligjin nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar si dhe VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

Specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP-së, si dhe nenit 40 Pika 2, të VKM-së nr 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance apo dhe çdo standard të kërkuar.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me Nenin 36 të LPP-së me Nenin 40 pika 2 të VKM 285. Specifikimet teknike, përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, në përputhje me nenin 36 të LPP-së dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara.

Specifikimet teknike janë hartuar në përputhje me rëndësinë e këtyre pajisjeve për procesin e mësimdhënies por edhe nga hapesirat e kushtëzuara nëpër shkollat përkatëse. Kurrikulat që zbatohen në shkollat e arsimit profesional kuhtëzojnë specifikimet pasi pajisjet që kërkohen janë pajisje që shërbejnë për procesin mësimor/didaktik dhe jo për veprimtari biznesi. Këto specifikime nuk çenojnë konkurrencën e drejtë dhe garantojnë pjesëmarrjen dhe përmbushjen nga disa kompani prodhuese në tregun vendas dhe të huaj. Studimi i tregut i kryer garanton ofrimin e këtyre pajisjeve nga minimalisht tre operatorë të ndryshëm vendas.

Në specifikimet teknike përcakohen qartë karakteristikat e punëve , shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet. Këto karakteristika lidhen dhe me procesin specifik ose me metoden e përdorimit ose ofrimin të furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore. Nëse ato janë të lidhura me objektin e kontrates dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Specifikimet teknike mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe nuk shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

Specifikimet teknike janë hartuar sipas standarteve kombetare që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standarteve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organe ndërkombëtare të standartizimit.

NJËSIA E PROKURIMIT